



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 19110 prot.

Data: 6, 10, 2023

VENDIM

Nr. 76, Datë 6, 10, 2023

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË,
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE TIRANË

Bazuar në ligjin nr. 23/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, në pikën 1, 3 të nenit 24 të ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015, nr. 48/2018, datë 23.7.2018; në pikën 2 të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021 për miratimin e “Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”, Neni 23 dhe neni 24, pika 2/d).

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike Tiranë, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin **Akreditim me kusht** nr. 7, datë 17.02.2023, me nr. 22386/4 prot. datë 17.02.2023 të MFE-së me afat vlefshmërie deri më 16.08.2023, për Kualifikimet profesionale të reja, sipas niveleve përkatëse në KSHK.
2. Mbështetur në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin e miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv **akreditim i plotë** dhe heqjen e kushteve të akreditimit për kualifikimet profesionale si më poshtë:

1) "Ekonomi biznes"	Niveli II në KSHK, L-II-17
2) "Llogari"	Niveli IV në KSHK, L4-IV-19
3) "Sigurime"	Niveli IV në KSHK, L2-IV-19
4) "Tregti"	Niveli IV në KSHK, L6-IV-20
5) "Sipërmarrje e Agjencisë Turistike"	Niveli IV në KSHK, L5-IV-19
6) "Administrim zyre"	Niveli IV në KSHK, L7-IV-21
7) "Tekstil - Konfeksione"	Niveli II në KSHK, KSHK D-II-17
8) "Modelim"	Niveli III në KSHK, D3-III-19
9) "Tekstil - Konfeksion"	Niveli IV në KSHK, D-IV-19
10) "Dizenjim mode"	Niveli V në KSHK, D1-V-14

3. Afati përfundimtar i **akreditimit të plotë** është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1/a të nenit 18 të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021 për miratimin e "Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional" Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike, Tiranë, do t'i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisimit të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ervin METE

